

**Ky dokument nuk është prova.** Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

## ARTIKULLI

|         |                                                                                                                                  |
|---------|----------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|
| TITULLI | LIVE- 81 vite burg për krerët e UÇK. Reagime dhe indinjatë në Prishtinë. Kërkohet zhbërja e Gjykatës Speciale - Euronews Albania |
| ADRESA  | https://euronews.al/live-liri-per-clirimtare-t-30-minuta-nga-aktgjykimi-ne-hage-vemendja-te-thaci-veseli-selimi-dhe-krasniqi/    |
| BURIMI  | euronews.al                                                                                                                      |
| GJENDJA | edited                                                                                                                           |

## KOHA


|                       |                                                                                                                                                           |
|-----------------------|-----------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|
| KAPUR NGA NE          | 16 shtator 2026, 07:44:17 UTC<br><i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>                            |
| DEKLARUAR NGA PORTALI | 16 shtator 2026, 07:43:17 UTC<br><i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i> |

## HASH-ET · SHA-256

|            |                                                                   |
|------------|-------------------------------------------------------------------|
| PËRMBAJTJA | a839d2ea0a644437b72cafe063d9529b3b4972485ef71da6e90a1c97ee45790ef |
| TEKSTI     | e6c587e2ecd18b28b81e997a1212edef704a66031c3164ad86b9a7f3edf36f37  |
| PAMJA      | 6d8c555ae97f158d7c93dadc21fce8f2b80afa7827ba2d032ec7d30d463b5fbb  |

## ZINXHIRI I PROVËS

|               |                                                                                                                                                                    |
|---------------|--------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|
| KJO HYRJE     | d22094eae7608834356487968e73567813a7c0e8e72e7f37d7bdaceb5c0cdcee                                                                                                   |
| E MËPARSHMJA  | 6095636c93931f4214093bcacfaabb3827776c44e39438b75af931acf1cc6c5d                                                                                                   |
| RRËNJA MERKLE | —                                                                                                                                                                  |
| ANKORIMI      | nuk është ankoruar ende<br><i>Kjo hyrje nuk është përfshirë ende në asnjë pemë Merkle të dërguar. Zinxhiri i hash-eve provon rendin dhe integritetin; koha jo.</i> |



## SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërin nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahajo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/d22094eae7608834356487968e73567813a7c0e8e72e7f37d7bdaceb5c0cdcee>

## PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px




## TREND

Gjyqi i UÇK Protesta në Tiranë Jordan Daci Ardit Bido Mark Rutte

KOSOVË | LAJM KRYESOR

## LIVE- 81 vite burg për krerët e UÇK. Reagime dhe indinjatë në Prishtinë. Kërkohet zhbërja e Gjykatës Speciale



## LAJMI I FUNDIT

22:27 Konstitucionalisti Daci: Ja si mund të zhbëhet vendimi i Hagës

22:18 Lela: Rama shkoi me helikopter në Prishtinë për të bindur liderët e Kosovës për Gjykatën Speciale

22:10 Vuçiq i zhgënjyer nga Haga, Bido: U viktimizua, ishte shumë i kënaqur me vendimin

16 Shtator 2026 | 09:43

SHPËRNDAJE  
ARTIKULLIN  
22:08 Gjali i Hashim Thaçit reagon pas dënimit të të atit me 25 vjet burg: Kjo betejë nuk ka mbaruar

Katër ish-krerët e UÇK-së janë dënuar me gjithsej 81 vite burg nga Dhomat e Specializuara të Kosovës në Hagë, në përfundim të aktgjykimit të shkallës së parë në çështjen gjyqësore ndaj Hashim Thaçit, Kadri Veselit, Rexhep Selimit dhe Jakup Krasniqit.

Ish-presidenti i Kosovës, Hashim Thaçi, është dënuar me 25 vite burgim, ish-kryetari i Kuvendit, Kadri Veseli, me 18 vite, Rexhep Selimi me 13 vite, ndërsa Jakup Krasniqi me 25 vite burgim.

Trupi gjykues i ka shpallur përgjegjësisë penalisht për krime lufte, përfshirë vrasje të paligjshme, torturë, trajtim mizor dhe ndalim të paligjshëm ose arbitrar. Në rastin e Thaçit, Dhomat e Specializuara konfirmuan dënimin për katër akuza për krime lufte: vrasje, torturë, trajtim mizor dhe ndalim arbitrar.

### Nuk u vërtetuan akuzat për krime kundër njerëzimit

Në të njëjtin aktgjykim, Trupi Gjykues nuk i ka gjetur të provuara akuzat për krime kundër njerëzimit ndaj katër të akuzuarve.

Gjatë shpalljes së aktgjykimit, gjykata konstatoi se Prokuroria nuk kishte arritur të vërtetonte ekzistencën e një sulmi të përhapur dhe sistematik kundër popullatës civile, element kyç për përcaktimin e përgjegjësisë për krime kundër njerëzimit.

Aktakuza ndaj Thaçit, Veselit, Selimit dhe Krasniqit përmbante gjashtë akuza për krime kundër njerëzimit dhe katër për krime lufte. Procesi lidhej me ngjarje të periudhës nga marsi 1998 deri në shtator 1999 në disa zona të Kosovës, si dhe në Kukës dhe Cahan në veri të Shqipërisë.

### Aktgjykimi i shkallës së parë

Shpallja e aktgjykimit është bërë më 16 shtator 2026 në selinë e Dhomave të Specializuara të Kosovës në Hagë. Seanca ishte publike dhe u transmetua në gjuhët shqipe, angleze dhe serbe

Të katër të akuzuarit kishin deklaruar më herët se nuk janë fajtorë për akuzat e ngritura ndaj tyre. Prokuroria Speciale kishte kërkuar nga gjykata dënim me nga 45 vite burgim për secilin, pra gjithsej 180 vite. Kjo ishte kërkesë e Prokurorisë dhe jo vendim i gjykatës.

Aktgjykimi i shkallës së dytë vendos shkallën e parë. Bëhet bërë të drejtë të specializuar

22:04 'Liria ka emër', Dua Lipa reagon pas vendimit të Hagës ndaj ish-krerëve të UÇK-së

21:52 Vendimi i Hagës për ish-krerët e UÇK, Bido: Një kartë e re në dorën e Serbisë kundër Kosovës

TESTIM

Aktgjykimi i Gjykatës Speciale vendosë përfundimtarisht se para, paraqitja e detyrë të operojnë vendimin në përputhje me procedurat e Dhomave të Specializuara.

### Procesi gjyqësor zgjati më shumë se tri vite

Gjykimi ndaj Hashim Thaçit, Kadri Veselit, Rexhep Selimit dhe Jakup Krasniqit nisi më 3 prill 2023. Prokuroria e përfundoi paraqitjen e provave më 15 prill 2025, ndërsa procedura e paraqitjes së provave u mbyll më 18 dhjetor 2025. Deklaratat përmbyllëse u mbajtën nga 9 deri më 18 shkurt 2026.

Sipas Dhomave të Specializuara, në proces kanë dëshmuar 134 dëshmitarë në sallën e gjyqit: 125 të thirrur nga Prokuroria, dy nga Mbrojtja e Viktimave dhe shtatë nga ekipet e Mbrojtjes. Në proces kanë marrë pjesë gjithsej 156 viktima.

### Vëmendja në Hagë dhe Prishtinë

Shpallja e aktgjykimit është ndjekur me vëmendje të madhe në Hagë dhe në Prishtinë. Para selisë së Dhomave të Specializuara në Hagë dhe në kryeqytetin e Kosovës janë mbledhur mbështetës të ish-krerëve të UÇK-së, ndërsa në Prishtinë janë organizuar tubime dhe është ndjekur publikisht procesi i shpalljes së vendimit.

Dhomat e Specializuara kishin paralajmëruar më herët se për shkak të interesimit të madh, hapësira për publikun në sallën e gjyqit ishte e kufizuar dhe pjesëmarrja fizike kërkonte regjistrim paraprak.

Aktgjykimi i sotëm shënon përfundimin e fazës së parë të procesit gjyqësor ndaj katër ish-krerëve të UÇK-së, por jo domosdoshmërisht përfundimin përfundimtar të çështjes, pasi vendimi mund të kundërshtohet përmes procedurave të apelit.

## 66 Updates

🕒 21:58

### Ministri Hoti flet për Euronews nga Haga: Drejtësia ndërkombëtare shpërbleu agresorin dhe dënoi viktimat

Gazetarja Esmeralda Mulaj bëri një lidhje live nga Haga për emisionin "Now me Erla Mehllin", ku zhvilloi një intervistë ekskluzive me Andin Hotin, ministrin për Punën, Familjen dhe Vlerat e UÇK-së, njëkohësisht djali i Ukshin Hotit, një prej figurave më të rëndësishme të rezistencës intelektuale dhe politike në Kosovë, i zhdukur pasi doli nga burgu i Dubravës në vitin 1999.

Hoti kishte një reagim të fortë dhe emocional pas vendimit të Gjykatës Speciale në Hagë, dhe e cilësoi drejtësinë ndërkombëtare si të padrejtë ndaj shqiptarëve, duke deklaruar se ajo "shpërblen agresorin dhe dënon viktimën". Sipas Hotit, vendimi i fundit dhe mënyra se si është trajtuar lufta në Kosovë janë dëshmi se Gjykata Speciale është ngritur dhe funksionon si një mekanizëm politik.

Hoti tha se në emër të popullit të Kosovës, personat e dënuar nga Gjykata Speciale janë çlirimtarë dhe jo kriminelë.

"Unë mendoj që drejtësia ndërkombëtare në shumë raste ka qenë e padrejtë ndaj popullit shqiptar. Në rastin konkret, shpërblen agresorin dhe dënon viktimën. Dhe besoj që kjo që ka ndodhur sot dhe ajo që ka ndodhur në të kaluarën është dëshmi e asaj që kam thënë edhe më herët, që kjo gjykatë është një gjykatë politike dhe është krijuar politikisht.

Në emër të popullit të Kosovës këta janë çlirimtarë, nuk janë kriminelë. Nuk mund të flasësh në emër të popullit të Kosovës dhe njëkohësisht të dënosh çlirimtarët e Kosovës.

Aty ku jam unë aktualisht, janë mbetjet mortore të 23 personave të zhdukur dhe të masakruar, të cilët janë gjetur para dy javësh në Zubin Potok. Këtu është edhe laborator i ku po bëhet përputhja e ADN-së.

Krejt Serbia deri më sot është dënuar me 61 vite burg për gjenocidin në Kosovë, ndërsa çlirimtarët tanë janë dënuar me 81.

Për mua ka qenë një moment emocional, sepse më kujtoi procesin e babait tim, para 32 vitesh, në Gjykatën e Qarkut të Prizrenit, ku ai u dënua nga autoritetet serbe për aktivitetin e tij politik për lirinë e Kosovës. Dhe kur shikon sot fytyrat e djemve të këtyre katër heronjve dhe sheh dhimbjen e tyre, është shumë e vështirë të përmbahesh. Kjo dhimbje vazhdon me dekada dhe me shekuj.

Sot në Kosovë janë ende 1 560 persona të zhdukur që kërkohen. Serbia refuzon të komunikojë për fatin e tyre. Serbia e bën Ratko Mladiqin hero. Ndërsa Bashkimi Evropian vetëm jep një deklaratë publike, financon, jep rrugë për në Bashkimin Evropian, ndërsa çlirimtarët e Kosovës dënohen", tha ai.

Shiko në:

21:22

### Amnesty International: Dënimet ndaj Thaçit dhe të tjerëve tregojnë se zyrtarët e lartë nuk janë mbi ligjin

Organizata për të drejtat e njeriut, Amnesty International, tha se dënimet për krime lufte ndaj ish-presidentit të Kosovës, Hashim Thaçi, dhe tre ish-zyrtarëve të tjerë të lartë të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, u japin shpresë viktimave që kanë pritur për drejtësi “për më shumë se dy dekada”.

Kështu u citua të ketë thënë Esther Major, zëvendës drejtoreshë rajonale për Evropën në Amnesty International, sipas një njoftimi në uebfaqen e organizatës.

Ajo tha se vendimet “tregojnë se zyrtarët e lartë nuk janë mbi ligjin” dhe se vendimet japin shpresën se “çdo përpjekje për të penguar drejtësinë, të vërtetën dhe reparacionet nuk do të tolerohet”.

Gjykata Speciale në Hagë i shpalli katër ish-krerët e UÇK-së fajtorë për katër akuza për krime lufte, ndërsa i liroi nga akuzat për krime kundër njerëzimit.

Hashim Thaçi dhe Jakup Krasniqi u dënuan me nga 25 vjet burgim, ndërsa Kadri Veseli me 18 dhe Rexhep Selimi me 13.

Aktgjykimi është i shkallës së parë dhe avokatët mbrojtës kanë paralajmëruar se do ta apelojnë atë.

SHBA-ja dhe shtetet e tjera kanë bërë thirrje që të respektohet vendimi.

Shpërndaje

21:17

### Gjermania bën thirrje që të respektohet vendimi i Speciales

Ambasadori gjerman në Kosovë, Rainer Rudolph, bëri thirrje të respektohet vendimi i Gjykatës Speciale, teksa shtoi se Kosova ka bashkëpunuar me mekanizmat ndërkombëtarë të drejtësisë.

“Duke themeluar Dhomat e Specializuara dhe duke bashkëpunuar me Tribunalin Ndërkombëtar Penal për ish-Jugosllavi, Kosova ka dëshmuar se ka kryer përgjegjësitë e saj, përfshirë ballafaqimin me krimet e luftës, si shtet i pavarur dhe sovran”, tha ambasadori Rudolph.

Sipas ambasadorit gjerman, vendimi ndaj ish-eprorëve të UÇK-së, “në asnjë mënyrë nuk i shfaqëson aktorët jugosllavë nga përgjegjësia për konfliktin e armatosur dhe shkeljet në shkallë të gjerë të të drejtave të njeriut të kryera ndaj popullit të Kosovës në fund të viteve '90, të cilat tashmë janë hetuar nga gjykatat ndërkombëtare dhe që nxitën ndërhyrjen e komunitetit ndërkombëtar”.

Shpërndaje

21:10

### HRW për vendimin e Speciales: Moment i rëndësishëm për viktimat që pritën për drejtësi

Organizata për të drejtat e njeriut, Human Rights Watch, e vlerësoi dënimin e katërshe të UÇK-së, si “moment të rëndësishëm për viktimat që kanë pritur me dekada për drejtësi”.

“Dënimi i ish-presidentit të Kosovës, Hashim Thaçi, së bashku me tre ish-udhëheqës të lartë të UÇK-së për krime lufte, tregon se pozitat e larta apo pozitat gjatë luftës nuk duhet të mbrojnë askënd nga përgjegjësia për krime të rënda”, tha Hugh Williamson, drejtori për Evropë dhe Azi Qendrore në HRW në një deklaratë të publikuar në rrjetet sociale.

Gjykata Speciale në Hagë i shpalli katër ish-krerët e UÇK-së fajtorë për katër akuza për krime lufte, ndërsa i liroi nga akuzat për krime kundër njerëzimit.

Hashim Thaçi dhe Jakup Krasniqi u dënuan me nga 25 vjet burgim, ndërsa Kadri Veseli me 18 dhe Rexhep Selimi me 13.

Aktgjykimi është i shkallës së parë dhe avokatët mbrojtës kanë paralajmëruar se do ta apelojnë atë.

SHBA-ja dhe shtetet e tjera kanë bërë thirrje që të respektohet vendimi.

 Shpërndaje

 20:50

### **“Do të përfundosh vetë në Hagë”, 12 vite më pas rikthehet paralajmërimi i Kurtit ndaj Thaçit**

Pas vendimit të Gjykatës Speciale në Hagë, e cila këtë të mërkurë dënoi me gjithsej 81 vite burg ish-krerët e UÇK-së, është rikthyer në vëmendje një video e vitit 2014, ku Albin Kurti paralajmëronte asokohe kryeministrin e Kosovës, Hashim Thaçi, për krijimin e kësaj gjykate të veçantë.

Në videon e publikuar, Kurti kundërshtonte krijimin e Gjykatës Speciale dhe i drejtohej drejtpërdrejt kryeministrit Thaçi, duke pretenduar se ai po e lejonte krijimin e tribunalit me bindjen se vetë nuk do të përfundonte përpara tij.

“Tribunali apo gjykata e veçantë nuk bëhet sikur ky kryeministër i Kosovës të mos donte të bëhej, por Thaçi po e lejon këtë tribunal pasi beson se ai vetë nuk ka për të përfunduar atje. Nëse ka ndonjë mik ndërkombëtar që mund ta ndihmojë Kosovën, duhet ta bëjë këtë duke i treguar kryeministrit që edhe ky vetë do të përfundojë aty”, shprehej Kurti.

Deklarata daton në prill të vitit 2014, kur Hashim Thaçi ishte kryeministër i Kosovës. Në atë periudhë, çështja e krijimit të një gjykate të veçantë për trajtimin e pretendimeve për krime të kryera gjatë dhe pas luftës së Kosovës ishte pjesë e debatit politik në vend.

Më 3 gusht 2015, Kuvendi i Kosovës miratoi ndryshimet kushtetuese që i hapën rrugë krijimit të Dhomave të Specializuara të Kosovës.

Videoja është rikthyer në vëmendje këtë të mërkurë, pas shpalljes së vendimit ndaj katër ish-krerëve të UÇK-së në Hagë, Hashim Thaçi, Jakup Krasniqi, Kadri Veseli dhe Rexhep Selimi, të cilët u dënuan gjithsej me 81 vite burg.

 Shpërndaje

 19:58

### **Konjufca: Aktgjykimi ndaj ish-krerëve të UÇK-së shkaktoi zhgënjim të thellë në Kosovë**

Zëvendëskryeministri i parë dhe ministri i Punëve të Jashtme dhe Diasporës, Glauk Konjufca, ka thënë se aktgjykimi dënues ndaj Hashim Thaçit, Kadri Veselit, Rexhep Selimit dhe Jakup Krasniqit ka shkaktuar zhgënjim të thellë në Kosovë, ndjenjë të cilën tha se e ndan edhe personalisht.

Ky është reagimi i tij i dytë pasi që Dhomat e Specializuara i shpallën fajtorë katër ish-krerët e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës për krimet e luftës të arrestimit dhe ndalimit të paligjshëm ose arbitrar, trajtimit mizor, torturës dhe vrasjes së paligjshme.

Thaçi u dënua me 25 vjet burgim, Veseli me 18 vjet, Selimi me 13 vjet, ndërsa Krasniqi me 25 vjet.

Konjufca shprehu bindjen se Dhoma e Apelit do ta shqyrtojë me kujdes dhe rigorozitet vendimin e shkallës së parë.

“Besoj fuqishëm se Dhoma e Apelit do t’ia nënshtrojë aktgjykimin një shqyrtimi të kujdesshëm dhe rigoroz gjyqësor, si dhe do t’i trajtojë, në përputhje me ligjin e zbatueshëm dhe praktikën e vendosur, mangësitë ligjore dhe faktike që dalin nga ky vendim”, shkroi ai në platformën X, transmeton KosovaPress.

Pavarësisht kësaj, Konjufca theksoi se përkushtimi i Kosovës ndaj sundimit të ligjit, parimeve demokratike, paqes dhe së ardhmes evropiane mbetet i pandryshuar.

Ai tha se historia e Kosovës është e karakterizuar nga represioni, rezistenca, lufta, humbjet dhe liria e fituar me shumë sakrifica.

“Sot, në rrethanat aktuale, është e vështirë të perceptohet një ndjenjë drejtësie për dhjetëra mijëra gra, burra dhe fëmijë, prej të cilëve më shumë se 95 për qind ishin shqiptarë etnikë, që u vranë, u dhunuan dhe u torturuan nga forcat ushtarake, paraushtarake dhe policore serbe. Për ta, drejtësia nuk erdhi kurrë”, deklaroi Konjufca.

Ai bëri thirrje që të mbahet e vërteta historike nga çdo shprehje dhe interpretim

Ai bën thirrje që të mbrohet e vërteta historike nga çdo shprehje e interpretimi keqdashës.

“Mbi të gjitha, duhet të mbetemi krenarë për dinjitetin dhe qëndrueshmërinë e popullit të Kosovës, si dhe për shtetin që kemi ndërtuar sot: një Kosovë të lirë, demokratike dhe evropiane”, përfundoi Konjufca në reagimin e tij.

[Shpërndaje](#)

🕒 19:30

### **“UÇK, UÇK”, protestuesit në Tiranë solidarizohen me ish-liderët e UÇK-së pas vendimit të Hagës**

Këtë të mërkurë shënohet dita e 109 e protestës së qytetarëve dhe aktivistëve në Tiranë.

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.